



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 32, datë 28.02.2022

MBI

**MIRATIMIN E PËRSHTATSHMËRISË DHE ZGJERIMIT TË LICENCËS SË
SHOQËRISË “BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE” SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572 datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 21, nenit 377, të Ligjit nr. 62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit” dhe Rregullores nr. 195, datë 29.12.2020 “Për licencimin e shoqërisë komisionere, regjistrimin e degës së shoqërisë së huaj komisionere dhe njohjen e shoqërisë së huaj komisionere”, e ndryshuar, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

K O N S T A T O I S E :

Ligji nr. 62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit” në nenin 377, pika 1, parashikon se: *“Të gjitha subjektet e licencuara në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 9879, datë 21.02.2008 “Për titujt”, vijojnë veprimtarinë për të cilën janë licencuar, me kusht që brenda 18 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të përshtaten me kërkesat e këtij ligji”.*

Për të vijuar veprimtarinë për të cilën është licencuar, banka duhet të përshtatet me kërkesat dhe kushtet e Ligjit nr. 62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit” dhe rregulloreve në zbatim të tij.

Shoqëria “Banka Amerikane e Investimeve” sh.a., aktualisht disponon licencën nr. 15/1 datë 19.12.2019, për ushtrimin e veprimtarisë së brokerimit (broker-dealer) të titujve në “Bursën Shqiptare të Titujve, ALSE” dhe në tregun me pakicë të titujve të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, si dhe licencën nr. 9, datë 31.10.2016 dhe licencën nr. 3, datë 28.04.2017, përkatësisht, si kujdestar i letrave me vlerë të Qeverisë së RSH dhe i obligacioneve të shoqërive aksionare dhe të qeverisë vendore. Licencat janë lëshuar sipas dispozitave të Ligjit nr. 9879, datë 21.02.2008 “Për Titujt”, i shfuqizuar.

Licenca që shoqëria “Banka Amerikane e Investimeve” sh.a., mban si shoqëri brokerimi (broker-dealer) për titujt që tregëtohen në bursë dhe tregun me pakicë të R.SH, nga pikëpamja e

veprimtarive të lejuara sipas Ligjit nr. 62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit” është e njëjtë me shërbimet e investimit si:

- Marrje dhe transmetim urdhërash të klientit;
- Ekzekutim urdhërash; dhe
- Tregtim për llogari të vet.

Nga pikëpamja e instrumenteve financiare, kjo licencë është e njëjtë me instrumentet e mëposhtme:

- Titujt e transferueshëm;
- Instrumente të tregut të parasë; dhe
- Kuota të sipërmarrjeve të investimeve kolektive.

Ofrimi i shërbimit të kujdestarisë në titujt e Qeverisë Shqiptare dhe obligacionet e shoqërive aksionare dhe të qeverisë vendore, sipas Ligjit nr. 62/2020, konsiderohet shërbim ndihmës (shërbimi i kujdestarisë apo ruajtja dhe administrimi i instrumenteve financiare në emër të klientëve).

Me qëllim përshtatjen e veprimtarisë, shoqëria “Banka Amerikane e Investimeve”, ka depozituar në Autoritet raportin e përshtatshmërisë, sipas kërkesave të Ligjit 62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit” dhe Rregullores nr. 195, datë 29.12.2020 “Për licencimin e shoqërisë komisionere, regjistrimin e degës së shoqërisë së huaj komisionere dhe njohjen e shoqërisë së huaj komisionere”, e ndryshuar.

Shoqëria “Banka Amerikane e Investimeve” sh.a., ka depozituar, gjithashtu, kërkesën dhe dokumentacionin për zgjerimin e licencës me qëllim ofrimin e shërbimeve shtesë të investimit, të shërbimeve ndihmëse, si dhe zgjerimin e llojeve të instrumenteve financiare.

Për sa më sipër, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare:

V E N D O S I:

1. Miratimin e përshtatshmërisë së shoqërisë “Banka Amerikane e Investimeve” sh.a. sipas kërkesave të Ligjit 62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit” dhe rregulloreve në zbatim të tij për:

A. Ofrimin e shërbimeve të investimit:

- **Marrje dhe transmetim i urdhrave;**
- **Ekzekutim i urdhrave në emër të klientëve; dhe**
- **Tregtim për llogari të vet.**

Për instrumentet financiare:

- **Titujt e transferueshëm;**
- **Instrumentet e tregut të parasë;**
- **Kuotat e sipërmarrjeve të investimeve kolektive.**

B. Ofrimin e shërbimit ndihmës në instrumentet e mësipërme si:

- **Ruajtja dhe administrimi i instrumenteve financiare në emër të klientëve.**

2. Miratimin e zgjerimit të licencës së shoqërisë “Banka Amerikane e Investimeve” për:

A. Ofrimin e shërbimeve të investimit:

- Administrimi i Portofolit;
- Këshillimi dhe dhënia e rekomandimeve për investime;
- Nënshkrimi i instrumenteve financiare dhe/ose hedhja në treg e instrumenteve financiare në bazë të angazhimit në transaksion; si dhe
- Hedhja në treg e instrumenteve financiare pa angazhim shitjeje.

B. Instrumentet financiare:

- Marrëveshjet e shkëmbimit (swap), kontratat që paracaktojnë normën e interesit në të ardhmen dhe çdo kontratë tjetër derivative lidhur me tituj, monedha, norma interesi ose kthimi (yields), të cilat mund të shlyhen fizikisht ose me para;
- Marrëveshjet e shkëmbimit (swap), kontratat e shitjes në të ardhmen me çmim të paracaktuar (forwards), që duhet të shlyhen në para ose që mund të shlyhen në para me zgjedhjen e njëres prej palëve, duke përjashtuar rastet e zgjidhjes së kontratës për mospërmbushje ose për ndonjë arsye tjetër;
- Marrëveshjet e shkëmbimit (swap) që mund të shlyhen fizikisht me kusht që të tregtohen në një treg të rregulluar, në një platformë shumëpalëshe tregtimi, ose në një platformë të organizuar tregtimi, me përjashtim të produkteve energjetike të tregtuara me shumicë në një platformë të organizuar tregtimi, të cilat duhet të shlyhen fizikisht;
- Marrëveshjet e shkëmbimit (swap), që mund të shlyhen fizikisht e që nuk janë përmendur në pikën më sipër, të cilat nuk mbahen për qëllime tregtare, por kanë karakteristikat e instrumenteve të tjera financiare derivative;
- Marrëveshjet e shkëmbimit (swap), kontratat që paracaktojnë normat e interesit në të ardhmen, e cila duhet të shlyhet me para ose mund të shlyhet me para me zgjedhjen e njëres prej palëve, duke përjashtuar rastin e zgjidhjes së kontratës për mospërmbushje apo ngjarje tjetër, duke mbajtur parasysh, ndër të tjera, nëse tregtohen në një treg të rregulluar, platformë të organizuar tregtimi ose platformë shumëpalëshe tregtimi.

C. Ofrimin e shërbimeve ndihmëse:

- Ruajtja dhe administrimi i instrumenteve financiare në emër të klientëve për të gjitha instrumentet financiare të listuar më sipër;
- Dhënia e kredive ose e huave një investitori për t'i dhënë mundësi të kryejë një transaksion me një ose më shumë instrumente financiare, ku shoqëria që jep kredinë ose huanë, ose një subjekt tjetër i lidhur me të, është e përfshirë në transaksion;
- Këshillimi i shoqërive tregtare në lidhje me strukturën e kapitalit, strategjinë industriale dhe çështjet e lidhura me to, këshillimi e ofrimi i shërbimeve për bashkimin dhe blerjen e shoqërive tregtare;

- Shërbimet e këmbimit valutor kur këto janë të lidhura me ofrimin e shërbimeve të investimit në tituj;
- Identifikimi i investimeve dhe kryerja e analizave financiare lidhur me to ose ofrimi i formave të tjera të rekomandimeve të përgjithshme në lidhje me transaksionet me instrumente financiare;
- Shërbimet e lidhura me dhënien e angazhimeve për blerjen e titujve.

3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Kapitaleve dhe Fondeve, si dhe Drejtoria e Licencimit për njoftimet dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Olsi ÇOKU

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Ervin METE